

VENDIM
Nr.9, datë 2.11.1992

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga:

Rustem Gjata	Kryetar	i Gjykatës Kushtetuese
Feti Gjilani	Zv/kryetar	i Gjykatës Kushtetuese
Manol Konomi	Anëtar	i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli	Anëtar	i Gjykatës Kushtetuese
Natasha Sheshi	Anëtar e	i Gjykatës Kushtetuese
Thimjo Kondi	Anëtar	i Gjykatës Kushtetuese
Ylvi Myrtja	Anëtar	i Gjykatës Kushtetuese
Veli Budo	Anëtar	i Gjykatës Kushtetuese

Me sekretare Drita Filto, me datën 2.11.1992, shqyrtoi në seancën gjygjësore me dyer të hapura çështjen nr.8 që i përket:

KËRKUESE: GJYKATA E APELIT TIRANË, e përfaqësuar nga kryetari, zoti Halil Kopani.

OBJEKTI: Pakushtetutshmëria e urdhëresës nr.1, datë 7.7.1989 e Këshillit të Ministrave "Për administrimin e kërkesave për banesa dhe për shpërndarjen e tyre".

GJYKATA KUSHTETUESE,

Pasi dëgjoi relacionin përkatës,

VËREN

Gjykata e rrethit Tiranë, duke gjykuar çështjen civile me paditës Bani Priftin kundër të paditurit Rifat Teqja, në caktimin e sipërfaqes së banimit i ka dhënë të parit një dhomë më tepër, mbasi gruaja e tij është "Heroinë e Punës".

Gjykata e Apelit Tiranë, të cilës i ka ardhur çështja mbi ankim, duke u mbështetur në nenin 8 të paragrafit të dytë të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", ka vendosur pezullimin e gjykimit të saj dhe ka dërguar materialet e çështjes Gjykatës Kushtetuese, duke çmuar, se Urdhëresa e Këshillit të Ministrave nr.1, datë 7.7.1989 "Për administrimin e kërkesave për banesa dhe për shpërndarjen e tyre", dhe konkretisht neni 2 paragrafi i katërt i saj vjen në kundërshtim me përmbajtjen e ligjit "Për dispozitat kryesore kushtetuese".

Në kushtet e tanishme kur fondet kryesore të banesave janë pronë e shtetit dhe administrohen prej tij, dhënia e të drejtës për të gëzuar sipërfaqe të tepërt banimi është një nder i veçantë që shoqëria dhe shteti u bën personave të caktuar apo kategori personash, për merita të veçanta shërbimi ndaj popullit dhe atdheut.

Edhe në të ardhmen do të ketë njerëz që do të vlerësohen në mënyrë të veçantë dhe që do të meritojnë titullin "Hero i Popullit", "Hero i Punës", etj.

Në rast se do të vërtetohet që ky ose ai titull nderi i është dhënë dikujt pa e merituar atë, organi që ka të drejtën të japë tituj të tillë ka edhe të drejtën t'i heqë ato.

Këshilli i Ministrave ka të drejtë të bëjë ndryshime apo plotësime në urdhëresën nr.1, datë 7.7.1989 "Për administrimin e kërkesave për banesa dhe për shpërndarjen e tyre", kur këtë e çmon të domosdoshme.

Prandaj përmbajtja e paragrafit të katërt të nenit 2 të urdhëresës në fjalë nuk vjen në kundërshtim me Ligjin "Për dispozitat kryesore kushtetuese".

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke pasur parasysh dhe nenet 24 e 26 të ligjit nr. 7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese".

VENDOSI

Prëzimin e kërkesës së Gjykatës së Apelit Tiranë.
Vendimi është përfundimtar dhe i formës së prerë.
Ky vendim hyn në fuqi me botimin e tij në "Fletoren Zyrtare"
Tiranë, më 2.11.1992